

Ref Nr: 00881/13/ek

Data: 27/05/2013

Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-079 (të ndryshuar) për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale; në bazë të nenit 11 paragrafi 1, nenit 12 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 18 paragrafi 1.3, nenit 8 dhe 19 paragrafi 1 dhe 2, nenit 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të nenit 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores nr. 07/2010, për emërimin e nëpunësve civilë, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Pronës nxjerr:

V E N D I M

- I. **Haki Sfishta**, pranohet në marrëdhënie pune, si nëpunëse i karrierës, në Zyrën e Financave, ZQ e AKP-së, në pozitën – **Udhëheqës i Buxhetit dhe Financave/Zyrtar Kryesor Financiar**.
- II. I lartpërmenduri si në pikën I të këtij Vendimi, do t'i nënshtrohet punës provuese në kohëzgjatje prej 12 muajsh, duke filluar prej dt. 01/06/2013 deri më datën 31/05/2014.
- III. I lartpërmenduri pas pranimit të këtij Vendimi është e obliguar të paraqitet në Njësinë e Burimeve Njerëzore, me qëllim të nënshkrimit të akt emërimit.

A r s y e t i m

Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil, me qëllim të zbatimit të konkursit të shpallur më dt. **06/03/2013**, në të përditshmen "Kosova Sot" dhe në ueb faqen e AKP-së, dhe duke vepruar në përputhje me parimet themelore për pranim në shërbimin civil, si dhe pas përfundimit me sukses të procedurës së rekrutimit, në mesin e kandidatëve më të suksesshëm për pozitën - **Udhëheqës i Buxhetit dhe Financave/Zyrtar Kryesor Financiar** e ka përzgjedhur dhe e ka propozuar kandidatin **Haki Sfishta**.

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura dhe duke vepruar konform nenit 4 paragrafi 2 të Rregullores nr. 07/2010, për emërimin e nëpunësve civilë, Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore e ka aprovuar propozimin e Komisionit përzgjedhës, dhe të njëjtin pastaj ia ka paraqitur Drejtorit Ekzekutiv për miratim përfundimtar.

Duke u bazuar në faktet e paraqitura si më lartë dhe në përputhje me dispozitat ligjore të theksuara në preambulë, u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Vendimi pala e paktënar mund të paraqesë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, Komisionit për Zgjidhjen e Kontestave dhe Ankesave.

Marian Nisora
Drejtor Ekzekutiv
Agjencia Kosovare e Pronës



Vendimi u dërgohet:
- Haki Sfishta
- Njësisë së Burimeve Njerëzore